



Datë: 11.06.2025

Numër Protokolli: 4229/2025

A.nr.633/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës –Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Arditë Haxhnikaj–Demi, anëtare, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.633/2025 të datës 10.04.2025 të parashtruar nga ankuesja F.H, kundër organit të punësimit: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 11.06.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.633/2025, e datës 10.04.2025, e parashtruar nga ankuesja F.H.

II. Mbetet në fuqi, Njoftimi i datës 14.03.2025, i Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, për kandidatin fitues për pozitën “*Udhëheqës i Divizionit për Mbështetje Gjuhësore*”.

A r s y e t i m

Ankuesja, F.H (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), më datë 10.04.2025, ka parashtruar ankesë me numër protokolli 2328/2024 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference RN00016372, për pozitën e punës “*Udhëheqës i Divizionit për Mbështetje Gjuhësore*”, në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 18.04.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, ndërsa kjo e fundit, më datë 02.05.2025, ka dorëzuar përgjigjet në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Tutje, Kryetari i Këshillit, me Vendim VK/2025 dhe me numër protokolli 3256/2025, të datës 19.05.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës me numër A.nr.633/2025, të parashtruar nga ankuesja edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 2382/2025 të datës 10.04.2025, të parashtruar nga ankuesja në Këshill; Konkursin me numër reference RN00016372 të datës 17.01.2025; Njoftimin e datës 28.02.2025; Njoftimin për kandidatin fitues të datës 14.03.2025; Dokumentin e identifikimit e ankueses; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 18.04.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 02.05.2025; Vendimin me Nr.78/2025 të datës 05.03.2025, për themelimin e Komisionit të Pranimit si dhe akt emërimet e anëtarëve; Listën përfundimtare të vlerësimit të kandidateve të datës 14.03.2025; Formularët e vlerësimit të eses dhe intervistës me gojë; Esetë dhe **testet me shkrim**; Aplikacionin e kandidatit L.D, të datës 23.01.2025, së bashku me dokumentet e bashkangjitura për konkursin përkatës; Aplikacionin e ankueses, të datës 14.02.2025, së bashku me dokumentet e bashkangjitura për konkursin përkatës.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa e ankueses, **është e pabazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, rrjedhë se Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, më datë 17.01.2025 ka shpallur Konkursin me numër reference RN00016732, për pozitën e kategorisë së ulët drejtuese "Udhëheqës i Divizionit për Mbështetje Gjuhësore", me afat aplikimi nga data 17.01.2025 deri me datë 16.02.2025.

Më tej, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë dymbëdhjetë (12) kandidatë, ku prej tyre njëmbëdhjetë (11) kandidatë janë përfshirë në listën e ngushtë, si kandidatë që kanë plotësuar kriteret për pozitën e shpallur, duke përfshirë këtu edhe ankuesen, e cila i është nënshtruar testimit me shkrim në të cilin ka arritur t'i mbledh gjithsejtë 15.4 pikë, nga rrjedh se ankuesja nuk ka arritur t'i marrë pikët e mjaftueshme për të vazhduar me fazën tjetër të vlerësimit atë të intervistës me gojë.

Divizionit i Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, pas përfundimit të procedurës së rekrutimit, gjegjësisht me datë 14.03.2025 ka publikuar Njoftimin për kandidatin fitues, nga i cili njoftim rezulton se kandidati L.D, me gjithsejtë 94.8 pikë të arritura nga kjo procedurë rekrutimi. është shpallur kandidat fitues për pozitën *Udhëheqës i Divizionit për Mbështetje Gjuhësore* në Departamentin e Shërbimeve të Përgjithshme.

Ankuesja, kundër njoftimit të lartë theksuar ka parashtruar ankesë në Këshill, mbi pretendimet ankimore se Komisioni Vlerësues nuk ka qenë i drejtë dhe objektiv, posaçërisht në vlerësimin e eses pasi që vetëm kandidati fitues ka kaluar testin me shkrim, duke theksuar se nga këto rrethana i është krijuar bindja se kandidati fitues ishte i vendosur paraprakisht, ashtu që e njëjta kërkon anulimin e njoftimit për kandidatin fitues dhe rikthimin e procedurës në fazën e testit me shkrim.

Kolegji i Këshillit, mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: "*Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes*", lidhur me këtë çështje ankimore ka analizuar shpalljen e Konkursit me numër reference RN00016372, për pozitën e kategorisë së ulët drejtuese *Udhëheqës i Divizionit për Mbështetje Gjuhësore* dhe si rrjedhojë nga analizimi i të njëjtit ka gjetur se kërkesa të përgjithshme formale në procedurën përkatëse të rekrutimit kanë qenë: **Arsimimi i kërkuar: Diplomën e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor), në Filologji, Juridik ose shkenca tjera shoqërore; Përvoja e punës e kërkuar: Së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale**, andaj Kolegji i Këshillit, konstaton se kërkesat e përgjithshme formale të sapo theksuara janë vendosur në pajtim me

dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, përkatësisht Shtojcës Nr.1/3 lidhur me përshkrimin e përgjithshëm të punës për klasën e Drejtues i Ulët.

Në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses, Kolegji i Këshillit, i' u referua legjislacionit në fuqi, respektivisht Nenit 44 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, si dhe dispozitave të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, gjegjësisht Nenit 9 ku përcaktohet se: *1. Vlerësimi nëpërmjet testimimit me shkrim është hapi i parë i procesit të vlerësimit profesional të kandidatëve pas verifikimit paraprak, dhe duhet të realizohet më së largu 15 ditë pas publikimit të listës së kandidatëve që kanë kaluar verifikimin paraprak. 2. Në testimin me shkrim, kandidatët vlerësohen për njohuritë, aftësitë dhe cilësitë kryesore të domosdoshme, të kërkuara për pozitën apo grupin e pozitës përkatëse. 3. Vlerësimi maksimal i mundshëm për testimin me shkrim është deri në shtatëdhjetë (70) pikë. 4. Testimin me shkrim e kalojnë vetëm kandidatët që marrin të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim. 5. Komisioni i Pranimit në përbërje të plotë është i obliguar ditën e zhvillimit të testimimit me shkrim të përzgjedhë nga bankat e pyetjeve që disponon Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, pyetjet e testit me shkrim të modelit zgjedhje e shumëfishtë me një përgjigje të saktë, si dhe një ese me shkrim, duke marrë parasysh fushat e njohurive dhe aftësive të përcaktuara në shpalljen për rekrutim. 6. Testi me shkrim përmban gjithsej njëzet e pesë (25) pyetje dhe një (1) ese të shkurtër. Secila përgjigje e saktë vlerësohet me dy (2) pikë, ndërsa eseja mund të vlerësohet me më së shumti njëzetë (20) pikë. 7. Kohëzgjatja e testimimit me shkrim është jo më shumë se nëntëdhjetë (90) minuta. 8. Anëtarët e Komisionit të Pranimit, vlerësojnë testin me shkrim në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, më së voni në afat prej dhjetë (10) ditësh nga dita e përfundimit të tij. Pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë vlerësohen nga sistemi në mënyrë elektronike, ndërsa eseja vlerësohet nga Komisioni i Pranimit. 9. Eseja vlerësohet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Pranimit në mënyrë individuale, të cilët e nënshkruajnë formularin e vlerësimit dhe vendosin pikët në SIMBNJ. Mbledhja e pikëve të secilit anëtar të Komisionit, nxjerr mesataren e vlerësimit përfundimtar për ese nga ana e Komisionit, për një kandidat të caktuar. Shuma e pikëve të vlerësuara nga sistemi dhe pikëve të esesë, përbën vlerësimin përfundimtar të testimimit me shkrim...., dhe se nga analizimi i shkresave të lëndës kandidatëve lidhur me procedurën përkatëse të rekrutimit rezulton se vlerësimi i testit me shkrim është realizuar në mënyrë elektronike, dhe se pyetjet e testit kanë qenë të njëjta për gjithë kandidatet, ndërsa nga provat e pranuar nga ankuesja, si dhe organi i punësimit, rrjedh se ankuesja ashtu sikurse kandidati i përzgjedhur i janë nënshtruar testit me shkrim, mirëpo ankuesja në fazën e testimimit me shkrim ka arritur t'i mbledh vetëm 15.4 pikë, respektivisht 14 pikë nga përgjigjet për pyetjet e testit me shkrim të modelit zgjedhje e shumëfishtë me një përgjigje të saktë dhe 1.4 pikë prej 20 pikëve sa ishte maksimumi i pikëve për esenë me shkrim, nga rrjedh se e njëjta nuk ka arritur t'i marrë pikët e mjaftueshme për të kaluar pragun e kalueshmërisë dhe rrjedhimisht për të vazhduar me fazën tjetër të vlerësimit, gjegjësisht intervistën me gojë, sikurse parashihet me dispozitat e Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenin 9 paragrafi 4 ku përcaktohet se: *4. Testimin me shkrim e kalojnë vetëm kandidatët që marrin të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim, ashtu që për sa më sipër nuk qëndron pretendimi ankimor i ankueses se organi përkatës i punësimit gjegjësisht Komisioni i Pranimit në këtë procedurë të rekrutimit nuk ka qenë i drejtë dhe objektiv, ngase të njëjtës nuk i është cenuar apo mohuar ndonjë e drejtë nga kjo procedurë rekrutimi, dhe se e vlerësimi i eses është në kompetencë të individuale të secilit anëtarë të Komisionit të Pranimit.**

Tutje, Kolegji i Këshillit, në kontest të shqyrtimit të kësaj procedure rekrutimit dhe duke u bazuar në dispozitat e sipër theksuara ligjore, ka analizuar aplikacionin e kandidatit fitues L.D, të datës 23.01.2025, nga i cili rezulton se i njëjti si dëshmi për plotësimin e kriterit arsimor, ka bashkangjitur Diplomën me Nr.785, të lëshuar me datë 20.07.2010 nga "Universiteti i Prishtinës", Fakulteti i Filologjisë, me anë të cilit dokument dëshmohet se i njëjti më datë 15.04.2010, ka mbaruar studimet themelore universitare në

Drejtimin Gjuhë dhe Letërsi Angleze dhe ka fituar titullin Bachelor i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze. Ndërsa sa i përket plotësimit të kriterit të përvojës tre (3) vjeçare të punës profesionale, kandidati në fjalë ka bashkangjitur Vërtetimin e Punësimit të lëshuar me datë 03.11.2016, nga European Union Rule of Law Mission "EULEX", me të cilën dëshkohet se i njëjti nga data 11.12.2008 deri më 14.06.2012, ka qenë i punësuar në pozitën e Asistent Administrativ/Gjuhësor (Shqip/Anglisht), nga data 15.06.2012 deri më 23.09.2014, ka qenë i punësuar në pozitën e punës Asistent i gjuhës Shqipe dhe Anglishte, ndërsa nga data 24.09.2014 deri më 14.11.2016, i njëjti ka qenë i angazhuar në pozitën Regjistruar Gjykatë në gjuhën Angleze, e cila përvojë pune tek ky Mision Ndërkombëtar është vërtetuar edhe përmes Pasqyrës së Llogarisë së Trustit Pensional; Vërtetimin e datës 28.07.2017, të lëshuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit, më anë të së cilit dokument dëshkohet se kandidati në fjalë nga data 01.05.2017 deri më 31.07.2017, ka qenë i angazhuar me kontratë për shërbime të veçanta në pozitën e Përkthyes i gjuhës Shqipe-Angleze dhe Anasjelltas; Vërtetimin e datës 21.01.2025, të lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, përmes të cilit dëshkohet se i njëjti nga data 07.08.2018 është emëruar shërbyes civil me akt emërimi të përhershëm, dhe se nga data 13.02.2024, e ushtron U.D Udhëheqës i Divizionit për Mbështetje Gjuhësore.

Andaj, bazuar në të gjeturat e sipër theksuara, Kolegji i Këshillit, konstaton se kandidati L.D, ka plotësuar kërkesat e përgjithshme formale, të përcaktuara me shpalljen e konkursit me numër Reference RN00016372, të datës 17.01.2025, për pozitën e punës v në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe duke qenë se i njëjti ka kaluar me sukses testin me shkrim me gjithsejtë 68.2 pikë dhe intervistën me gojë me gjithsejtë 26.6 pikë, duke mbledhur kështu gjithsejtë 94.8 pikë të përgjithshme nga kjo procedurë rekrutimi, si rrjedhojë i njëjti ka fituar të drejtën për tu shpallur kandidat fitues, në pajtueshmëri me dispozitat e nenit 11 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: *1. Vlerësimi përfundimtar i kandidatit përfshin shumën e pikëve të përfituara në secilin hap të vlerësimit. 2. Pas përfundimit të intervistës, Komisioni i Pranimit përgatit listën përfundimtare të kandidatëve që kanë kaluar pragun prej 70% të pikëve totale që e përcjell te NjMBNj, emrin dhe mbiemri e kandidatit fitues, si dhe pikët e arritura në testin me shkrim, intervistën dhe pikët e përgjithshme për secilin kandidat.*

Kolegji i Këshillit, duke bazuar në rrethanat dhe konstatimet si me sipër, konstaton se Komisioni i Pranimit dhe rrjedhimisht Sektori i Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës, me rastin e zhvillimit të procedurës së rekrutimit për pozitën përkatëse të punës ashtu sikurse edhe shpalljen e Njoftimit të datës 14.03.2025, për kandidatin fitues për pozitën *Udhëheqës i Divizionit për Mbështetje Gjuhësore* në Departamentin e Shërbimeve të Përgjithshme, ka zbatuar drejtë ligjin material, duke vepruar kështu në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrarët Publik dhe Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kështu që, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të mbetet në fuqi Njoftimit i datës 14.03.2025, për përzgjedhjen përfundimtare të kandidatit fitues për pozitën e punës *Udhëheqës i Divizionit për Mbështetje Gjuhësore* në Departamentin e Shërbimeve të Përgjithshme të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, siç përcaktohet në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.633/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses F.H;
- Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve; si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.